



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:239713
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05474468

2023:239714

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, gjyqtarja Mirlinda Bytyqi Rexhepi, në çështjen juridike sipas padisë të paditësit R.Sh. nga Ferizaj, të cilën me autorizim e përfaqëson av.Samir Rekaj nga Ferizaj, kundër të paditurës KS ‘E.’ me seli në Prishtinë, me bazë juridike kompensim i dëmit, jashtë seancës gjyqësore më datën 19 mars 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET- e tërhequr padia e të paditësit R.Sh. nga Ferizaj e ushtruar kundër të paditurës KS ‘E.’ me seli në Prishtinë, me bazë juridike kompensim i dëmit.

A r s y e t i m

Paditësi R.Sh. nga Ferizaj të cilën me autorizim e përfaqëson av.Samir Rekaj nga Ferizaj me datë 07.11.2023 ka ushtruar padi për kompensim dëmi kundër të paditurës KS ‘E.’ me seli në Prishtinë, dhe ka kërkuar që të miratohet padia si e bazuar.

I autorizuari i paditësit, ka dorëzuar një gjykatë parashtrësë me datën 06.03.2024 për tërheqjen e padisë kundër të paditurës, pasi me të njëjtën kanë arritur marrëveshje jashtë gjyqësore.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga nenin 261, lidhur me nenin 387.1 pika c, e Ligjit të Procedurës Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-

2023:239714 dt. 19.03.2024

Gjyqtarja

Mirlinda Bytyqi Rexhepi

KESHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.